

LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 7: Nëntor 2020 - Shkurt 2021



Të dashur prindër,

urojmë të jeni mirë, ju, familja juaj dhe të dashurit tuaj.

Jetojmë në kohëra sfiduese dhe të gjithë jemi duke u përballur me sfida të shumta, kryesisht për shkak të pandemisë që duket se nuk do të përfundojë shumë shpejt. Para pak ditësh, për shkak të motit të acartë dhe me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë mësimi kaloi plotësisht online, për një javë.

Pavarësisht kufizimeve dhe pengesave, ne jemi të vendosur të japim më të mirën dhe të

arrijmë më të mirën e mundshme për nxënësit tanë.

Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të disa ngjarjeve kryesore të zhvilluara që nga muaji nëntor. Do të kishim dashur të zhvillonim akoma edhe më shumë veprimtari dhe projekte, ashtu siç edhe e kishim të planifikuar, por për arsye që njihen tashmë na është dashur të zvogëlojmë numrin e aktiviteteve, të ndryshojmë formatin e tyre apo të ulim numrin e pjesëmarrësve.

Ju falënderojmë për mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj në çdo fushë, veçanërisht për përshtatjet

dhe ndryshimet e vazhdueshme që na është dashur t'i bëjmë, shpesh edhe brenda një afati të shkurtër kohor.

Së bashku do t'ia dalim.

Me respekt,

Elona Rira
Drejtoresh e Shkollës NEHEMIA

elona.rira@ng.team

AKTIVITETE

Kopshti

Mësueset dhe fëmijët e kopshtit kanë organizuar aktivitete të brendshme me rastin e festave të nëntorit dhe të fundvitit. Gjithashtu janë zhvilluar edhe aktivitete me tematika të ndryshme, si p.sh. Unë i dua kafshët, punëdore me tema të ndryshme etj.

.....

Arsimi fillor

Klasat I-V zhvillojnë çdo të premte një larmi veprimtarish, ku nxënësit mund të shprehin talentet e tyre, të mësojnë dhe të argëtohen njëkohësisht. P.sh. Vizita tek serat, kërcime, teatër dhe lojëra të ndryshme.

.....

Projekti social, nëntor 2020

Nxënësit e Shkollës NEHEMIA nuk janë të përqendruar vetëm në arritjet e tyre akademike. Ata duan të ndihmojnë edhe njerëzit përreth tyre që nuk janë me aq fat sa ata. Kështu, me mbështetjen miqësore të "The Ideas Partnership UK", nga data 23 - 27 nëntor nxënësit e shkollës se mesme shpërndanë 60 pako me mjete të ndryshme shkollore, si dhe me nga një libër jashtë shkollor, për fëmijët e shkollës në dy fshatra përreth Pogradecit. Gjithashtu, nxënësit kishin përgatitur 11 pako ushqimore për familjet në nevojë dhe me mbështetjen e mësueseve të tyre Xhensila dhe Fabjola, si edhe të bashkëpunëtorëve të projektit social, ata i përgatitën këto pako dhe shkuan në fshatra për ti shpërndarë ato. "Ndihma për njerëzit në nevojë është dhe do të jetë gjithmonë, një nga qëllimet kryesore të nxënësve të Shkollës NEHEMIA," tha Frensi Angjo, drejtuesi i qeverisë së nxënësve.

Në datat 7 - 11 dhjetor, në Korçë u zhvillua **olimpiada „Rroke Shkencën“** për lëndët: Shkenca Sociale, biologji-kimi, fizikë, informatikë dhe matematikë me pjesëmarrje të shkollave nga i gjithë qarku.

Në nivel gjimnazi, në lëndët biologji, kimi dhe matematikë Shkolla NEHEMIA mori çmimin e parë; në informatikë çmimin e dytë dhe si shkollë, në rang qarku, çmimin e dytë. I përgëzojmë nxënësit për këto rezultate, falënderojmë mësuesit për punën dhe angazhimin e tyre dhe u urojmë të gjithëve suksese të mëtejshme.



Punëdore



Teatër



Ndihma për njerëzit në nevojë



Olimpiada „Rroke Shkencën“

Takimi me prindërit në dhjetor u zhvillua në një tjetër format. Për të shmangur grumbullimet, takimet me secilin prind u shpërndanë përgjatë një jave, mbasditeve, ku secili prind kishte një orar të caktuar. Ju falenderojmë për pjesëmarrjen tuaj, pasi këto takime janë vërtet shumë të rëndësishme për të arritur së bashku një arsimim sa më të mirë të fëmijëve tanë.

.....

Muajt nëntor-dhjetor janë muaj intensivë, ku nxënësit testohen në të gjitha lëndët për të parë ecurinë e tyre, por edhe për të përfutur nga sistemi i pikëve NCTS, ku nxënësit me rezultate shumë të larta fitojnë pikë, të cilat në fund të vitit shkollor mbledhen dhe përkthehen në ulje të pagesës shkollore. Këto testime, të quajtura ndryshe testime të jashtme ose të drejtorisë së shkollës, janë pjesë e rëndësishme e menaxhimit të cilësisë në shkollë.

.....

Koncerti i Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri u organizua në një format më të vogël dhe të këndshëm. Nxënësit u përgatitën me entuziazëm dhe këtu <https://www.facebook.com/NehemiahGateway/videos/675926743097784> ju mund të rishikoni performacën e tyre.

.....

DATA TË RËNDËSISHME:

Faza e dytë e prezantimit të BCG do të zhvillohet më 5 mars 2021. Gjate kësaj faze nxënësit do të prezantojnë analizën e bërë për një biznes lokal.

Bursa e Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari

Edicioni nr. 3 i Bursës së Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari tashmë është i hapur. Kjo është një mundësi për të gjithë nxënësit e klasave të nënta nga rrethi i Pogradecit që duan të ndjekin studimet e gjimnazit në Shkollën NEHEMIA në Pogradec. Aplikimet mbyllen në 31 mars 2021. (Facebook: Lyhnida Fund)

I UROJMË MIRËSEARDHJEN

Victoria Bevard



Victoria aktualisht është në vitin e fundit të studimeve në Universitetin Duke, në Karolinën e Veriut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për

shkak të pandemisë, ajo është duke ndjekur online studimet e saj për "Filozofi dhe Ekonomi". Victoria ka ardhur në Pogradec në fillim të muajit Janarit 2021 dhe do të jetë vullnetare tek Nehemiah Gateway duke ndihmuar, midis të tjerash, nxënësit e shkollës në klubet e debatit dhe në projektin BCG (Business at School). Victoria ka një përvojë të gjatë në fushën e debatit. Ajo ka garuar në Debatin e Kongresit (Congressional Debate) gjatë gjithë shkollës së mesme dhe në vitin 2016, ka fituar Kampionatin Kombëtar, nga Shoqata e Ligjeratës dhe Debatit (National Speech and Debate Association (NSDA)). Në kolegji ajo themeloi organizatën jofitimprurëse The Triangle Debate League (triangledebate.com) për të ofruar falas trajnime debati. Victoria, gjithashtu, ka një formim në biznes dhe menaxhim, të cilin shpreson ta ndajë me nxënësit e BCG. Asaj i ka bërë përshtypje entuziazmi i nxënësve tanë dhe është e lumtur që do të punojë me ta.

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA

Nehemia 7304 Buçimas,
Pogradec Albania

Tel.: +355 83 600 403

Fax: +355 83 600 405

shkolla-nehemia@ng.team